



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE  
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1223/1 Prot

Tiranë, më 17.03 2014.

U R D H Ë R

Nr 29, datë 17.03 2014

“PËR

NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR.620 DATË 22.11.2012 “PËR  
MIRATIMIN E LLOJEVE TË DEKLARATËS SË INTERESAVE PRIVATE”.

Në zbatim të nenit 15 gërmë a), të nenit 40 pika 1, gërmë d) dhe nenit 21 të Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, dhe në Rregulloren e Brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Konrollit të Pasurive dhe Konflikti të Interesave,

Me arsyetimin se:

Me urdhërin nr.620, datë 22.11.2012 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKP, ”Për miratimin e llojeve të deklaratës së interesave private” botuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, të vitit 2012, janë miratuar format e deklaratës së interesave private, ”Para fillimit të detyrës”, ”Periodik/Vjetor”, ”Pas largimit nga detyra” dhe ”Me kërkëse”.

Në faqen 12 të formularëve sipas modelit të miratuar, është përcaktuar dhe mënyra e plotësimit të tyre, me shkrim dore ose në mënyrë elektronike.

Nisur nga fakti se formulari i deklarimit konsiderohet dokument zyrtar dhe duhet të përbajë të gjithë elementet e një dokumenti zyrtar, duhet të shmanget plotësimi me shkrim dore, duke paraqitur saktësi, seriozitet dhe estetikë,

U R D H Ë R O J:

Në faqen nr.12 të deklaratës së private para fillimit të detyrës, deklaratës së interesave private periodik/vjetor dhe deklaratës së interesave private pas largimit nga funksioni, bëhet ndyshimi si vijon:

Fjalia ”Formulari i Deklarimit të plotësohet me shkrim dore ose në mënyrë elektronike, por në çdo rast nënshkruhet me shkrim”, zëvëndësohet me fjalinë: ”Formulari i Deklarimit plotësohet vetëm në mënyrë elektronike (me kompjuter)”. Pas printimit të formularit të plotësuar sipas kërkësave ligjore, bëhet nënshkrimi për çdo fletë të tij, sipas rubrikave përkatëse.

Zyrtari plotëson dhe nënshkruan dokumentin nga faqja 1 deri në faqen 7 të tij.

Personi i lidhur (bashkëshorti/ja dhe fëmijët madhorë) plotëson dhe nënshkruan, në raset si vijon:

- a- Kur kanë pasuri të regjistruar veçmas në emër të tyre plotësojnë në mënyrë elektronike vetëm me kompjuter faqen 7-11
- b- Kur nuk kanë pasuri të regjistruar veçmas në emër të tyre plotësojnë vetëm faqen nr 8.

2. Dorëzimi i deklaratës nga zyrtari do të bëhet vetëm në zyrën e Autoritetit Përgjegjës të institucionit publik ku punon.

3. Bazuar në shkronjën “d)” nen 40 të Ligjit nr 9049 datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publike*” i ndryshuar, mos plotësimi në mënyrë elektronike dhe me kompjuter i deklararatës së interesave private para fillimit të punës, deklaratës së interesave private peridik/vjetor dhe deklarata e interesave private pas largimit nga funksioni përbën shkelje ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

---

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**Shkëlqim CANAJ**

